



Pfadibewegung Schweiz
Mouvement Scout de Suisse
Movimento Scout Svizzero
Swiss Guide and Scout Movement

SKAUT

sq



TË KRIJOJMË MIQËSI TA KALOJMË KOHËN E LIRË SË BASHKU TË GATUAJMË TË LUAJMË TË BËJMË SPORT DHE MUZIKË TË MERREMI ME PUNË DORE PËR VAJZA DHE DJEM

Të jesh skaut (Pfadi) do të thotë që të kesh përjetime të paharrueshme, miqësi dhe shumë gëzime së bashku me fëmijë apo të rinj/të reja moshatarë. Kryesorja për ne është jeta në bashkësi. Këtu fëmijët e mësojnë dhe praktikojnë gjuhën, mësojnë lojta të reja dhe gjithçka fëmijët në Zvicër bëjnë me qejf. Ato/ata mund të shfrenjë, të luajnë, të qeshin, të këndojnë, të gatujnë dhe të merren me punë dore. Njëkohësisht, ato/ata mësojnë të kenë përgjegjësi për veten e të tjerët dhe ta kalojnë kohën e lirë në mënyrë të arsyeshme dhe të pavarur.

Në të shumtën e rasteve, grupet takohen të shtunave pasdreke për dy deri katër orë. Nganjëherë edhe për një fundjavë të tërë ose për një kamp disaditor. Këto aktivitete realizohen pa prindër dhe udhëheqen nga të rriturit/et të rinj/të reja, të cilët/at janë të kualifikuar mirë dhe përkrahuren nga të rriturit.

Skautët (përk. boyskautë dhe girlskaute) janë organizata më e madhe e të rinjve/të rejave në Zvicër. Ata janë të pavarur politikisht dhe për sa i përket religjionit.

Secili/secila mund të marrë pjesë në skautë. Në krahasim me aktivitete të tjera të kohës së lirë, skautizmi nuk kushton shumë para. Nëse, megjithatë, dikush nuk mund t'i përballojë shpenzimet për pjesëmarrjen dhe pajisje: nuk është problem; në skautë do të gjejmë patjetër një zgjidhje!

Skautët janë organizuar në grupe kudo në Zvicër. Nëse keni ndonjë pyetje ose doni të informoheni për pjesëmarrjen, mund të lidheni me personin vijues:

